

Nr. 11601 Prot.
Datë 27.12.2016.



REPUBLIKA E SHQIPËRISE
DHOMA KOMBËTARE E PËRMBARIMIT PRIVAT
PËRMBARUES GJYQËSOR PRIVAT ELVIN HOXHA
CERTIFIKATE NR.206/JANAR 2015 NIPT.L42109004H
Adresa: Rruga "Vaso Pasha" Nr.13/1, Ap.1, Tirane
E-mail: elvinth@hotmail.com Mob: +355682029920

Nr.106/16
Nr. 2086 Prot.

Tiranë më datë 27/12/2016

URDHËR

(PËR VËNIEN E SEKUESTROS KONSERVATIVE)

Drejtuar : QËNDRËS KOMBËTARE TË REGJISTRIMIT

Per Dijeni : Debitorit , Shoqërisë "Media 99"sh.a.me Nipt K21817006K për subjektin televiziv OSHMA "KOHA TV"
Kreditorit, Autoriteti i Mediave Audiovizive (AMA)

Prane zyres se Permbaruesit Gjyqesor Privat Elvin Hoxha eshte depozituar kerkesa e pales kreditore Autoriteti i Mediave Audiovizive (AMA) sëbashku me Vendimin për lëshimin e Urdhërit të Ekzekutimit nr. Regj. Them. 2232 (31100-08392-80), datë 01.11.2016 të lëshuar nga Gjykata Administrative Shkallës së Parë Tiranë, me palë:

-Kreditor: Autoriteti i Mediave Audiovizive (AMA)

-Debitor: Shoqëria "Media 99"sh.a.me Nipt K21817006K
për subjektin televiziv OSHMA "KOHA TV"

-Objekti: Lëshimi i Urdhërit të Ekzekutimit për Vendimin "Sanksion Gjobë" nr. 8, datë 11.03.2016 të Autoriteti i Mediave Audiovizive (AMA)


Me Vendimin për lëshimin e Urdhërit të Ekzekutimit nr. Regj. Them. 2232 (31100-08392-80), datë 01.11.2016 të lëshuar nga Gjykata Administrative Shkallës së Parë Tiranë, është vendosur:

1- Pranimi i kërkesës së Kërkuesit Autoriteti i Mediave Audiovizive (AMA)

2-Lëshimin e urdhërit të ekzekutimit për aktin administrativ Vendimin "Sanksion Gjobë" nr. 8, datë 11.03.2016 të Autoriteti i Mediave Audiovizive (AMA).

Referuar Vendimit të Gjobës me nr. 8, datë 11.03.2016, sanksionon subjektin e sipërpermendur me masën **2,000,000 (dy milion) Lekë**

Ne kushtet kur per ekzekutimin e Vendimin për lëshimin e Urdhërit të Ekzekutimit nr. Regj. Them. 2232 (31100-08392-80), datë 01.11.2016 të lëshuar nga Gjykata Administrative Shkallës së Parë Tiranë, nuk eshte permbushur detyrimi ne menyre vullnetare , nga ana e Permbaruesit Gjyqesor Privat duhet te kryhet vendosja e mases se sekuestros konservative ne kuotat/aksionet e pales debitore Shoqërisë "Media 99"sh.a.me Nipt K21817006K për subjektin televiziv OSHMA "KOHA TV".



Si në zbatim të neneve 527 e në vijim të K.Pr.Civile dhe ligjit nr.10031 , datë 11.12.2008 “Për Shërbimin Përmbarimor Gjyqësor Privat”

URDHEROJ :

1-Vendosjen e mases se sekuestros konservative ne kuotat/aksionet e pales debitore **Shoqëria “Media 99”sh.a.me Nipt K21817006K për subjektin televiziv OSHMA “KOHA TV** , si dhe mbi te drejtat qe rrjedhin nga zoterimi i ketyre kuotave duke ndaluar tjetersimin dhe/ose disponimin e tyre si dhe mos kryerjen e asnje veprimi tjetër i cili mund te ndryshoje te dhenat ne regjistrin tregtar. Dokumentacioni do te qendroje i bllokuar deri ne nje urdher te dyte nga Permbaruesi Gjyqesor Elvin Hoxha .

- Shoqëria “Media 99” sh.a identifikuar me Nr.Nipt K21817006K , për subjektin televiziv OSHMA “Koha Tv”
- Rruga “Vllazën Huta” , Pallati Vila Park , Shkalla 1 , Ap 1 , Tiranë.


2- Per veprimet apo mos veprimet tuaja duhet te na vini ne dijeni shkreserisht brenda afatit ligjor

3- Personat qe behen pengese , do te pergjigjen ne baze te nenit 606 K.Pr.Civile (paragrafi II) qe parashikon vendosjen e sanksionit te gjobes dhe kallezimit penal.

4- Ky urdher mbahet ne disa kopje dhe u njoftohet paleve te cilat kan te drejten e ankimit ne Gjykate brenda 5 (pese) diteve.

PËRMBARUES GJYQËSOR PRIVAT

ELVIN HOXHA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA ADMINISTRATIVE E SHKALLËS SË PARË
TIRANË

Nr. Regj.Them. 2232(31100-08392-80)
Dt. Regj 21.10.2016

Datë vendimi 01.11.2016

VENDIM
"NË EMËR TË REPUBLIKËS"

Gjykata Administrative e Shkallës së parë Tiranë e përbërë prej :

GJYQTAR : EMILJANO RULI

Asistuar nga sekretare gjyqësore Dorjana Guxo, në Tiranë, sot më datë 01.11.2016, mori në shqyrtim në seance gjyqësore me dyer të hapura kërkesën 2232 Akti, që i përket:

KËRKUES: Autoriteti i Mediave Audiovizive, me seli në rrugën "Abdi Toptani", Tiranë, perfaqësuar me ane të autorizimit nr 954 prot date 3121.10.2016 nga znj.Edra Dedaj.

OBJEKTI: Lëshim i urdhrimit të ekzekutimit për sanksionin me gjobë nr. 8 datë 11.03.2016 në masën 2.000.000 lekë, të vendosur nga Grupi i Inspektimit të AMA-s, ndaj shoqërisë "Media 99", sh.a, për subjektin televiziv OSHMA "Koha TV".

BAZA LIGJORE: Neni 511, germa "ç" i Kodit të Procedurës Civile, Ligji nr.49/2012 "Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative", i ndryshuar.

Gjykata, në datën 01.11.2016, pasi shqyrtoi kërkesën e palës kërkuese e cila kërkonte pranimin e kërkesës sipas objektit.

VËREN:

- Pranimin e kërkesës së kërkuarit Autoriteti i Mediave Audiovizive.
- Lëshim i urdhrit të ekzekutimit për aktin administrativ gjohë nr.8 datë 11.03.2016 në masën 2.000.000 lekë, të vendosur nga Grupi i Inspektimit të AMA-s, ndaj shoqërisë "MEDIA 99" sha, për subjektin televiziv OSHMA "Koha TV".
- Ky urdhër lëshohet vetëm në një kopje.
- Shpenzimet gjyqësore siç janë bërë.

Tiranë, më 01.11.2016

SEKRETARE
DORJANA GUXO

GJYQITAR
EMILJANO RULI